- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit **Kontraktor [vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
 - (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontratës;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 - 7. Listat e Çmimeve të Artikujve.
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

⁴ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Date _____	

Shtojca 2.

[Në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmimin më të ulët, nga operatori ekonomik plotësohet dhe paraqitet vetëm kjo Shtojcë]

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

ç) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontratës;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;

6. Kushtet e Veçanta të Kontratës.

d) Norma e fitimit e shprehur në vlere absolute është si më poshtë

1	2	3
Nr	Përshkrimi i mallrave	Norma e fitimit

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Kujdes: Bazuar në parashikimet e nenit 45/2.1 të VKM Nr. 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, kur si kriter vlerësimi përdoret “oferta ekonomikisht më e favorshme bazohet në çmimin më të ulët”, autoriteti kontraktor përlllogarit çmimin bazuar në:

- a) çmimin e bursës, së datës kur është publikuar njoftimi i kontratës së procedurës së prokurimit, i konvertuar sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë të kësaj date;
- b) elementet fiskale;
- c) normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës;

Shtojca 3.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit: _____

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE): _____

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Sasisë dhe grafikut për Mallrat duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa vlerë do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të çojë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

1	2	3	4	5	
Artikulli	Përshkrimi i mallit	Sasia	cmimi per njesi	Çmimi total për artikull (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total (Mallrat)				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					
Nënshkrimi					

Vula	
Date _____	

Shtojca 4.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]*

Në emër të: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]*

* * *

Procedura e prokurimit *[lloji i procedurës]*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[objekti]*

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike *[Data]* *[Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-së.*

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e *[emri i autoritetit kontraktor]* vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në *[njoftimin e kontratës]*.

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 5.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 6.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;

b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit në mjedis;

c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:



SPECIFIKIMET TEKNIKE


OBJEKTI : “BLERJE ORENDISH DHE PAJISJESH PËR MOBILIM TË AMBIENTEVE TË KËSHILLIT TË QARKUT VLORË”

Nr.	Emërtimi	Specifikime	Foto ilustruese
1.	Dollap metalik me kanata rrëshkitëse (120x45x200)	Dollap metalik me kanata rrëshkitëse duhet të ketë strukturë prej çeliku të lyer që ti rezistojë korrozionit dhe përkuljes. Dollapi duhet të sigurojë mbyllje me çelës. Dollapi është me kanata rrëshkitëse. Hapësira e brendshme e dollapit ndahet në 5 hapësira. Sergjenet ndarës duhet të kenë përshtatje lartësie jo më shumë se 30 mm dhe të kenë aftësi mbajtëse jo më pak se 50 kg. Këmbët e dollapit duhet të kenë mundësi nivelimi. Të plotësojë kërkesat e Standartit CEN/TR 14073-1:2004, EN 14073-2:2004, EN 14073-3:2004, EN 14074:2004	
2.	Raft për dosje etazher (90x45x190)	Skeleti dhe Sergjenet do jenë prej materiali melamine me trashësi 16 deri 18 mm. Kapakët janë me material MDF të plastifikuar me PVC me spesor jo më pak se 16 deri 18 mm. Xokula do të jetë 8 cm e lartë dhe prej të njejtit material. Bordet anësore të skeletit, sergjeneve dhe kapakëve të jenë të rrethuara me material plastik PVC. Poshtë fiankeve do ketë tapa fundore kundër gërvishtjes. Në pjesën e poshtme deri në lartësinë 72 cm, do të ketë dy kapakë prej materiali melaminë, me trashësi jo më të vogël se 18 mm që mbyllën me çelës. Dollapi brenda këtyre dy kapakëve do jetë i ndarë në dy pjesë me anë të një sergjene me lartësi të regjistrueshme. Pjesa e sipërme është e mbyllur me kapakë xhami (që mund të jenë me ose pa kornizë druri ose metali). Hapësira brenda kapakëve të xhamit do ndahet në tre hapësira me anë të sergjeneve që janë të regjistrueshëm sipas nevojës. Dorezat dhe aksesoret e	

		përdorur të jenë cilësorë mundësisht prej metali të kromuar. Të plotësojë kërkesat e Standartit CEN/TR 14073-1:2004, EN 14073-2:2004, EN 14073-3:2004, EN 14074:2004	
3.	Karrike rrotulluese zyre me bazament dhe krah mbështetës metalik	Karriget rrotulluese të kenë shpinore të regjistrueshme me mekanizëm për ulje-ngritje me piston. Karria do të mbështetet mbi një bazament në formë ylli prej materiali metalik me 5 rrota në ekstremet e tyre. Rrotat të jenë me material plastik ngarkesë-mbajtës. Krahët mbështetës të karrikes të jenë metalik dhe ngarkesë mbajtës. Tapiceria të jetë në stof të cilësisë së parë ose lëkurë ekologjike. Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 1335-1:2021, SSH EN 1335-2:2018	
4.	Karrike statike pa krah mbështetës	Karriget të jenë dizenuar me një stil modern. Thellësia e ulëses e përshtatshme për përdorues të rritur. Skeleti përbëhet prej një tubi petashuq ovale 30 x 15 mm me spesor jo më të vogël se 1.3 mm, i cili përshkon shpinoren në dy anët e saj dhe ndenjësen. Montohen në skeletin metalik me vida. Me mbushje gome sintetike me densitet të lartë. Lyerja me boje elektrostatische. Tapiceria të jetë lëkurë ekologjike. Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 1335-1:2021, SSH EN 1335-2:2018	
5.	Karriqe për rangun drejtues	Karria statike duhet të jetë me tapiceri prej lëkure origjinale natyrale kadore, me shpinore të lartë dhe rezistonte ndaj zjarrit. Shpinorja duhet të jetë e përshtatshme në pozicionet vertikalisht si dhe para e prapa. Duhet të ketë krahë anësore me tub inoksi. Thellësia e ulëses, e përshtatshme për përdorues të rritur. Bazamenti duhet të jetë metalik me 5 degëzime në formë ylli. Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 1335-1:2021, SSH EN 1335-2:2018	

6.	Poltron statik për tavolinë mbledhje	Me tapiceri prej lëkure ekologjike, me shpinore të lartë. Të ketë krahë anësore. Thellësia e ulëses e përshtatshme për përdorues të rritur. Skeleti përbëhet prej një tubi petashuq i kromuar, i cili përshkon shpinën në dy anët e saj, ndenjësen dhe zbret në tokë duke u mbyllur në formë U, duke luajtur dhe rolin e bazamentit. Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 1335-1:2021, SSH EN 1335-2:2018	
7.	Tavolinë e madhe mbledhje	Tavolina do të jetë me këto përmasa: 630 cm e gjatë, 240 cm e gjerë në qendër, dhe 77 cm lartësi. Syprina do jetë me trashësi 7 cm. Këmbët do kenë lartësi 70 cm. Materiali që do përdoret për tavolinën do jetë tamburat i rimesuar me rimeso arre natyrale, e lyer, me rezistencë të lartë kundër gërvishtjeve dhe njollave. Këmbët janë me plane të të njëjtit material dhe trashësi të syprinës dhe të harkuara në uniformë të plotë me pjesën anësore të tavolinës. Pjesa e poshtme e syprinës të jetë e mbrojtur nga agjentët atmosferik. Druri i arrës që rrethon pjesën anësore të syprinës të jetë i njëtrajtshëm me lulet e rimesos së arrës. Bashkimi i planit të punës (syprinës) me këmbët bëhet në mënyrë të tillë, që i jep tavolinës pamje solide. Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 527-1:2011, SSH EN 527- 2:2016 + A1:2019 (EN, e njëvlefshme ose e përditësuar), SSH EN 13721:2004	
8.	Tavolinë drejtuesi në formë L – je e madhe	Syprina melaminë me trashësi 2.5 cm. Veshje laminate me rezistencë të lartë kundër gërvishtjeve dhe njollave. Këmbët janë me material melamine trashësi 18 mm. Bordet anësore të planit të punës dhe të këmbëve të jenë të rrethuara me material plastic PVC 0.8 mm. Bashkimi i planit të punës me këmbët bëhet në mënyrë të tillë që i jep tavolinës pamje solide. Pjesa ballore është e pozicionuar e tillë	

		që realizon bashkimin e planit të punës me këmbët e tavolinës dhe qëndron në një hapësirë 40 cm, nga plani i dyshemesë. Aksesoret që përdoren për montimin e elementeve të tavolinës të jenë cilësorë. Këmbët të jenë me mekanizëm nivelues. Tavolina e punës në pjesën e brendshme ka të montuar në njërin krah një bllok sirtarësh ku sirtari i parë të jetë i mbyllur me çelës. Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 527-1:2011, SSH EN 527-2:2016 + A1:2019 (EN, e njëvlefshme ose e përditësuar), SSH EN 13721:2004 <i>Tavolinë pune</i> (gjatësi x gjerësi x lartësi): 140 x 70 x 72 cm, <i>Tavolinë kompjuteri</i> 90 x 70 x 72 cm, <i>Hark Lidhës</i> 90 gradë me përmasa 70 x 70 cm, <i>Tavolina e mbledhjes</i> 130 x 70 x 75 cm	
9.	Tavolinë zyre	Tavolina e punës përbëhet nga syprina prej materiali melaminë me trashësi 2.5 cm me borde anësore të plastifikuara me PVC 0.8 mm. Dy anësoret dhe harku lidhës përbëhen nga materiali melaminë me trashësi 1.8 cm. Bashkimi i elementëve të tavolinës së punës bëhet me aksesore të padukshëm. Tavolina e punës mbështetet mbi këmbë plastike po ashtu skeleti i tavolinës së kompjuterit përbëhet nga melaminë me trashësi 1.8 cm njësoj si pjesa tjetër dhe poshtë tavolinës vendoset një pjesë për mbajtjen e tastierës së kompjuterit. Komodina mbështetet mbi rrota dhe ka tre sirtarë me doreza të hapshëm me shina ku sirtari i parë detyrismisht duhet të ketë edhe bravë. Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 527-1:2011, SSH EN 527-2:2016 + A1:2019 (EN, e njëvlefshme ose e përditësuar), SSH EN 13721:20 <i>Tavolinë pune</i> (gjatësi x gjerësi x lartësi): 120 x 70 x 72 cm; <i>Tavolinë kompjuteri</i> (gjatësi x gjerësi x lartësi):	

		90 x 70 x 72 cm; Hark Lidhës 70 x 70 x 72 cm; <i>Sirtarë komodine</i> (gjatësi x gjerësi x lartësi): 40 x 42 x 62 cm	
10.	Tavolinë pune e thjeshtë (140x80x75)	Syprina melaminë me trashësi 2.5 cm. Veshje laminati me rezistencë të lartë kundër gërvishtjeve dhe njollave. Këmbët janë me planë të të njëjtit material dhe trashësi të syprinës. Bordet anësore të planit të punës dhe të këmbëve të jenë të rrethuara me material plastik PVC. Bashkimi i planit të punës me këmbët bëhet në mënyrë të tillë që i jep tavolinës pamje solide. Pjesa ballore është e pozicionuar e tillë që realizon bashkimin e planit të punës me këmbët e tavolinës dhe qëndron në një hapësirë 40 cm, nga plani i dyshemesë. Në pjesën e brendshme në njërin krah ndodhet posti i tastierës e fiksuar me shina rrëshqitëse, në krahun tjetër ndodhen dy sirtarë me gjerësi 45 cm ku sirtari i parë të jetë i mbyllur me çelës. Montimi i tastierës duhet të jetë i thjeshtë dhe me mundësi zgjedhje të krahut të punës. Aksesorët që përdoren për montimin e elementëve të tavolinës të jenë cilësorë. Në planin e punës të jetë e hapur një vrimë, në të cilën fiksohet një mekanizëm plastik në formë cilindri dhe bën të mundur kalimin e kablllove nga lart poshtë dhe anasjelltas. Këmbët të jenë me mekanizëm nivelues. Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 527-1:2011, SSH EN 527-2:2016 + A1:2019 (EN, e njëvlefshme ose e përditësuar), SSH EN 13721:2004	
		Strukturë me tuba cilindrik çeliku me sipërfaqe të lëmuar, të kromuar dhe ku është montuar paraprakisht me shpim, me vrima të padukshme nga jashtë syprina MDF, me shtresë të jashtme laminat të plastifikuar, të niveluar dhe të palëvizshme. Mbështetja e structures në dysheme, duhet të ketë katër tapa	

11.	Tavolinë e vogël mesi, drejtuesi (115cmx60cmx43cm)	plastike për të mundësuar përdorimin, mos dëmtimin e dyshemesë përkatëse (si, psh. nga gërvishtjet) dhe të zbusë rrëshqitjen pa shkaktuar zhurma. Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 527-1:2011, SSH EN 527-2:2016 + A1:2019 (EN e njëvlefshme ose e përditësuar), SSH EN 13721:2004. Përmasat e tavolinës të jenë jo më pak se 53x48x43 cm ku lartësia nuk duhet të kalojë 43 cm	115cmx60cmx43cm
12.	Poltron pritje dyvendësh (kolltuk dyvendësh)	Të jetë me skelet druri. Të jetë I dizenuar me linja të drejta tën stilit modern. Me tapiceri prej lëkure ekologjike të jë cilësie të lartë/material mikrofibër që lahet. Sfungjeri i përdorur të jetë cilësor. Përmasat 186 cm x 95 cm x 94 cm. Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 13759 : 2012	
13.	Komodinë zyre (45x60x65)	Materiali i përdorur do jetë melamine me trashësi 1.6 deri 1.8 cm. Veshje laminati me rezistencë të lartë kundër gërvishtjeve dhe njollave. Bordet anësore të elementëve përbërës të jenë të veshur me material plastik PVC. Dorezat e kanateve dhe aksesoret e përdorur të jenë cilësorë. Të plotësojë kërkesat e Standartit SSH EN 527-1:2011, SSH EN 527-2:2016+A1:2019 (EN, e njëvlefshme ose e përditësuar), SSHEN 13721:2004	
14.	Perde roller	Perde roller për zyra. Ngjyra dhe materiali do të përcaktohen në bashkëpunim me AK.	
15.	Aksesor mbajtës perde, metalik (shina për perde)	Shina duhet të jenë njëshe me material alumini për perde. Të montohen në tavan dhe mur.	
		Thellësia e brendshme 2.5cm e këtij dollapi 180 x 120cm do të thotë se është e lehtë të montosh njoftime. Veshjet elegante prej alumini sigurojnë	

16.	Tabelë druri për të varur shënimet (e mbyllur)	një mënyrë tërheqëse dhe të qëndrueshme për të kornizuar informacionin dhe njoftimet tuaja të rëndësishme. Dera me mbyllje me celës përmban panel akrilik transparent rezistent dhe siguri. Rubber-Tak është një sipërfaqe me strukturë unike e prodhuar nga gome e ricikluar për të siguruar qëndrueshmëri të pakrahasueshme. Vrimat e kunjve praktikisht zhduken në sipërfaqen e vetë-shërimit, e cila është gjithashtu rezistente ndaj njollave. Goma është rezistente ndaj lagështirës, rezistente ndaj kimikateve dhe nuk do të mbështesë rritjen e mykut ose baktereve. Paneli akrilik i qartë rezistent ndaj copëtimit Zgjidhni midis mbështjellësve prej gome-tak, tape natyrale ose vinili. Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 1729-1:2015: SSH EN 1729-2:2012 +A1:2015	
-----	---	--	---

Shenim: Nëse mallrat nuk janë sipas specifikimeve të mësipërme Komisioni nuk do i marrë në dorëzim.

Afatet e lëvrimit të mallit : 20 (njëzet) ditë nga lidhja e kontratës

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

OBJEKTI I PROKURIMIT: “BLERJE ORENDISH DHE PAJISJESH PËR MOBILIM TË AMBIENTEVE TË KËSHILLIT TË QARKUT VLORE”

PREVENTIVI

NR.	EMËRTIMI	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI	VLEFTA
1	Dollap metalik me kanata rrëshqitëse (120x45x200cm)	copë	3		
2	Raft për dosje etazher (90x45x190cm)	copë	13		
3	Karrike rrotulluese zyre me bazament dhe krah mbështetës metalik	copë	14		
4	Karrike statike pa krahë mbështetës	copë	25		
5	Karrige për rangun drejtues	copë	2		
6	Poltron statik për tavolinë mbledhje	copë	23		
7	Tavolinë e madhe mbledhjesh (630x240x77cm)	copë	1		
8	Tavolinë drejtuesi në forme L-je e madhe	copë	1		
9	Tavolinë zyre	copë	1		
10	Tavolinë pune e thjeshtë (140x80x75)	copë	2		
11	Tavolinë e vogël mesi, drejtuesi (Përmasat e tavolinës të jenë jo më pak se 53 x 48 x 43 cm ku lartësia nuk duhet të kalojë 43cm) 115x60x43	copë	1		
12	Poltron pritje dyvendësh (kolltuk dyvendësh)	copë	3		
13	Komodinë zyre (45x60x65)	copë	7		
14	Perde role	m ²	20.12		
15	Aksesor mbajtës perde metalik	ml	14.164		
16	Tabelë druri për të varur shënimet (e mbyllur)	copë	1		
	SHUMA				
	TVSH				

	TOTAL	
--	--------------	--

Shenim: Nëse mallrat nuk janë sipas specifikimeve të mësipërme Komisioni nuk do i marrë në dorëzim.

Afatet e lëvrimit të mallit : 20 (njëzet) ditë nga lidhja e kontratës

Shtojca 8.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pagtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, **sipas Shtojcës 9.**

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfasuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetin kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas kriterëve të përgjithshme të pranim/kualifikimit

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023 -2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës.

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetimet që dëshmojnë se kanë paguar detyrimet përkatëse, të tarifave dhe taksave vendore, në përputhje me përcaktimet e ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 5, pika c në të gjitha vendet ku kanë ushtruar aktivitetet sipas të dhënave të QKB – së për vitin 2024 (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin e lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilin është regjistruar në QKB).

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohet vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

2.3.2. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë një staf punonjësish prej **minimalisht 3 (tre) persona**, ndër të cilët 1 (një) shofer dhe 2 (dy) punonjës për transportin e mallit. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit e vërtetuar kjo me :

- a) Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve, për të paktën muajin e fundit të deklaruar.
- b) List pagesa e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, për të paktën muajin e fundit të deklaruar.

Kjo kërkesë, do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e Formularit shtojcës Nr. 9 (**Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit**). Ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, sipas parashikimeve të pikës 6, të nenit 26, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.3.3. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

- a) 1 (një) mjet transporti mallrash mbi 1.5 ton (në pronësi apo me qera) i cili do të shërbejë për transportin e mallrave deri në ambientet e Autoritetit Kontraktor.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Për mjetin në pronësi duhet të paraqiten :

- Certifikatë pronësie
- leje qarkullimi
- kontrolli teknik (SGS) (i vlefshëm)
- taksat e mjetit të paguara (të vlefshme)
- siguracioni (i vlefshëm)

Për mjetin e marrë me qera duhet të paraqiten :

- kontratë qeraje e vlefshme gjatë ekzekutimit të kontratës dhe në formën e kërkuar nga ligji.
- Certifikatë pronësie
- leje qarkullimi
- kontrolli teknik (SGS) (i vlefshëm)
- taksat e mjetit të paguara (të vlefshme)
- siguracioni (i vlefshëm)

Kjo kërkesë, do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e Formularit shtojcës Nr. 9 (**Formulari Përmbledhës i Vetdeklarimit**). Ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimimit, sipas parashikimeve të pikës 6, të nenit 26, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.4. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1. Operatori Ekonomik duhet të disponojë dhe paraqesë certifikata të vlefshme :

- ISO 9001 : 2015 (Sistemi i menaxhimit të cilësisë) ose ekuivalente të vlefshme dhe të akredituara nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtar Akreditues, të njohura nga Republika e Shqipërisë

2.4.2. Subjekti ofertues duhet të paraqesë edhe deklaratat si më poshtë :

- a) Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë garancie të mallrave që kërkohen të prokurohen nëpërmjet së cilës duhet të marrë përsipër dhe të garantojë : riparimin, mirëmbajtjen dhe shërbimin pa pagesë, të defekteve për shkak të prodhimit dhe

transportit për një periudhë 1 (një) vjecare nga koha e marrjes në dorëzim të artikujve nga autoriteti kontraktor.

- b) Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit, nga nënshkrimi i kontratës sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor.
- c) Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një deklaratë ku të cilësojë se mallrat e ofruara prej tij, janë të reja dhe jo të përdorura apo të rikonstruktura.

Shënim: Në zbatim të pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, ku parashikohet: “*Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla*”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “*Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.....etj. Ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë dokumentat provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.*

Për dokumentat e ofertës, të ngarkuara në sistemin e prokurimit elektronik, ofertuesi i kualifikuar i pari duhet t’i paraqesë këto dokumenta në origjinal ose të njësuar me origjinalin. Gjithashtu, dokumentet provuese, që do të paraqiten për të provuar vetëdeklarimet e bëra, duhet të paraqiten në origjinal ose të njësuar me origjinalin dhe të provojnë gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij.....”, sjellim ne vemendje se:

- Disponimi i dokumentave të kërkuara më sipër do të dëshmohet nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit gjatë fazës së ofertimit.
- Autoriteti/enti kontraktor përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit duhet t’i dërgojë kërkesë në rrugë elektronike (nëpërmjet sistemit të APP) ofertuesit të kualifikuar i pari, që të dorëzojë dokumentet provuese/mbështetëse për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.
- Mosparaqitja e dokumentacionit do të jetë kusht s’kualifikimi si dhe do të veprohet sipas nenit 83 pika 3 dhe 5 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.
- Autoriteti Kontraktor do të bëjë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimet e bëra gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mospërputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përbën kusht s’kualifikimi.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca 9.

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik
_____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	-----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Informacione për nënkontraktorin

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t’u nënkontraktuar

• **Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit

ekonomik, si më poshtë:
etj. nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv). <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

B: DEKLARATA

Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

Në cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, **Deklaroj Se:**

Jam në dijeni të pasojave që vinë ndaj meje lidhur me këtë Deklaratë, në respektim të ligjit nr. 9121/2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

Kam përgatitur ofertën në mënyrë të pavarur, pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër⁶.

Në veçanti, pa kufizuar si më lart, nuk kam pasur kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent me qëllim cënimin e konkurrencës, në lidhje me:

- a) çmimet;
- b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
- c) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
- d) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.

Nuk kam pasur marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent, me qëllim cënimin e konkurrencës, në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë.

Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t’u bëhen të njohura, me qëllim cënimin e konkurrencës, në çdo mënyrë qoftë, konkurrentëve të tjerë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj.

⁶ Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që: a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor; b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.

C: DEKLARATA

Mbi Konfliktin e Interesit

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:

Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.

Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:

